



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rruga: "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 22268141; 22268142

Nr. 673/6 Prot.

Tiranë, më 16.03.2017

V E N D I M

Nr. 50, datë 16.03.2017

***"Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 673/1 prot., datë 25/11/2016"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procesin e verifikimit të disa pretendimeve të ngritura nga nëpunësi ***** , për shkelje të kryera gjatë liritimit nga shërbimi civil,

VËREJ SE:

Me Urdhrin nr. 673/1 prot., datë 25/11/2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u shqyrtua informacioni i përcjellë nëpërmjet ankesës, paraqitur nga ***** , për ndërprerje të pa drejtë të marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil.

Në zbatim të urdhrin të mësipërm, nëpërmjet shkresës nr. 673/2, datë 25.11.2016, "Njoftim mbi fillimin e verifikimit", është vënë në dijeni Zyra Arsimore Tepelenë për këtë proces, duke i kërkuar edhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e tij.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, nga institucioni është dërguar shkresa nr. 673/5 prot, datë 07.12.2016, drejtuar Komisionerit, dhe së bashku me të është dërguar edhe dokumentacioni përkatës, i cili është administruar në dosjen e materialeve të mbledhura gjatë hetimit administrativ.

Nga analiza e këtij rasti rezulton se, Zyra Arsimore Tepelenë, nëpërmjet shkresës nr. 309 prot., datë 04.07.2016, i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike, duke e informuar në lidhje me nëpunësit të cilët kishin plotësuar formularët e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”*, brenda afatit të përcaktuar. Nga përmbajtja e kësaj shkrese, rezulton se ankuesi nuk ka kryer detyrimin e plotësimit dhe depozitimit të formularit të vetëdeklarimit.

Departamenti i Administratës Publike, pasi ka bërë verifikimin e dokumentacionit që shoqëronte shkresën e mësipërme, me aktin nr. 3638/2 prot., datë 18.07.2016, *“Kthim përgjigje të shkresës nr. 309 prot., datë 04.07.2016,”*, ndërmjet të tjerave, ka konstatuar se punonjësi ***** , i cili është subjekt i ligjit nr. 138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, nuk ka plotësuar dhe depozituar formularin e vetëdeklarimit dhe për këtë arsye, ka kërkuar nga Zyra Arsimore Tepelenë, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e pikës 3, të nenit 15, të ligjit të sipërcituar, për lirim e tij nga detyra.

Zyra Arsimore Tepelenë, me shkresën nr. 536 prot., datë 05.10.2016, e ka njoftuar këtë punonjës, për fillimin e procedurës së marrjes së vendimit të largimit nga detyra, për shkak se nuk ka dorëzuar brenda afatit ligjor, formularin e vetëdeklarimit pranë organit përgjegjës, duke e konsideruar këtë veprim si refuzim për të përmbushur një detyrim ligjor. Në bazë të ligjit nr.138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, personi vendoset në të njëjtën situatë sikur të ketë rezultuar në një nga rrethanat që përbën kusht për ndalimin e emërimit të tij në një funksion publik.

Në përfundim të këtij procesi, me Vendimin nr. 559 prot., datë 20.10.2016, Drejtuesi i Zyrës Arsimore Tepelenë, në zbatim të nenit 15, të ligjit nr.138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, të nenit 66, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, *“Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin 138/2015”*, ka vendosur lirimin e ankuesit ***** me detyrë *“Specialist në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse”*.

Ky vendim vlerësohet në përputhje me ligjin pasi, pretendimi i ankuesit se nuk kishte dijeni që ishte pjesë e shërbimit civil, nuk mund të merret parasysh, nisur nga fakti se, si nëpunës i administratës publike duhet të ketë njohuri për legjislacionin shqiptar në përgjithësi dhe atë të shërbimit civil, në veçanti. Padijenja e ligjit nuk e shkarkon nga përgjegjësia.

Në këto rrethana, arrihet në përfundimin se, veprimi administrativ i kryer nga ana e Zyrës Arsimore Tepelenë, për lirim nga detyra të punonjësit në fjalë, është kryer në përputhje me kërkesat e ligjit për nëpunësin civil, si dhe të ligjeve specifike që e rregullojnë këtë aspekt.

Për këtë arsye, në bazë të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”* si dhe nenit 34 të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duhet të vendoset përfundimi i procedimit administrativ.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 90 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, neneve 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenin 34, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me urdhrin e verifikimit nr. 673/1 prot., datë 25/11/2016, “Për ndërprerje të pa drejtë të marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil”, për shkak se nuk konstatohen shkelje në veprimin administrativ të kryer nga ana Zyrës Arsimore Tepelenë për lirim nga detyra “Specialistit në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse”, e punonjësit *****.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Zyra Arsimore Tepelenë, Departamenti i Administratës Publike dhe ankuesi *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA